



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 01.03.2017

Ref.: 126/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

- I. REFUZHET kërkesa nr.675/16, dt. 17.11.2016 e BPrAL Kolegji "Universum" për akreditim të tri specializimeve: Menaxhimi i Edukimit; Menaxhimi i Prokurimit; dhe Menaxhimi në Drejtësi; në kuadër të programit të studimit Menaxhment, MA (120 ECTS).
- II. REFUZHET kërkesa nr.778/16, dt. 15.12.2016 e BPrAL Kolegji "Universum" për akreditim të programit të studimit:
 - Juridik, LLB (240 ECTS)
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Universum" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të tri specializimeve: Menaxhimi i Edukimit; Menaxhimi i Prokurimit; dhe Menaxhimi në Drejtësi; në kuadër të programit të studimit Menaxhment, MA (120 ECTS).

Gjithashtu BPrAL Kolegji "Universum" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit Juridik, LLB (240 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017 ka vlerësuar aplikacionin e datës 17.11.2016 të BPrAL Kolegji "Universum" për akreditim të tri specializimeve: Menaxhimi i Edukimit; Menaxhimi i Prokurimit; dhe Menaxhimi në Drejtësi; në kuadër të programit të studimit Menaxhment, MA (120 ECTS). Duke u bazuar në nenin 5, pika 2 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve

të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016) akreditimi bëhet vetëm në nivelin e Institucionit dhe të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit për akreditim të tri specializimeve të cekura më sipër.


Gjithashtu Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 23 shkurt 2017 ka vlerësuar aplikacionin e datës 15.12.2016 të BPrAL Kolegji "Universum" për akreditim të programit të studimit: Juridik, LLB, (240 ECTS) dhe pas shqyrtimit të dosjeve të stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji "Universum".


Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga BPrAL Kolegji "Universum", KSHC konstaton se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këtë programet e studimit të cekura më sipër, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit të BPrAL Kolegji "Universum".

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Universum"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



**KOLEGJI
 UNIVERSUM**

Adresa: Imzot Nik Prelaj p.n, Ulpianë, Prishtinë, Kosovë
 Tel: +381 38 555 315
 Mob: + 377 45 303425, 44 144 062
 URL: <http://www.universum-ks.org>
 Mail: info@universum-ks.org

DATË/A:	15.11.2016
REFERENC-Ë:	2780/2
PËR:	Znj. Furtuna Mehmeti U.D. e Drejtoreshës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim
NGA:	Alejtin Berisha, Drejtor Ekzekutiv
TEMA:	Kërkesë për aplikimin e programeve të reja

Të nderuar,

Me këtë letër përcjellëse të bashkangjitur gjeni dokumentet e nevojshme për aplikim për akreditim të programeve të reja.

Programet të cilat do te aplikojnë për akreditim janë

- Infermieri-Mami BA niveli VI, 180 ECTS, Dega ne Ferizaj ✕
- Arkitekture , BA niveli VI, 180 ECTS, Kampusi Kryesor
- Mirëqenie Sociale, BA niveli VI, 180 ECTS, Dega ne Ferizaj
- Shkenca Kompjuterike MSC, niveli VII, 120 ECTS, Kampusi Kryesor f

Programet te cilat do te aplikojnë për riakreditim janë

- MA në Menaxhment, niveli VII, 120 ECTS, Kampusi Kryesor me specializim Menaxhimi i Edukimit, Menaxhimi i Prokurimit dhe Menaxhimi në Drejtësi. ✓


Të gjitha këto dokumente në gjuhën shqipe dhe atë angleze, janë të vendosura edhe në formë elektronike (CD)

Me respekt
 Alejtin Berisha



(Handwritten signature)

KOLEGJI UNIVERSUM



Adresa: Imzot Nik Prelaj p.n, Ulpianë, Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 555 315
Mob: + 377 45 303425, 44 144 062
URL: <http://www.universum-ks.org>
Mail: info@universum-ks.org

DATË/A:	15.12.2016
REFERENC-Ë:	2262
PËR:	Znj. Furtuna Mehmeti U.D. e Drejtoreshës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim
NGA:	Alejtin Berisha, Drejtor Ekzekutiv
TEMA:	Kërkesë për aplikimin e programeve të reja

Të nderuar,

Me këtë letër përcjellëse të bashkangjitur gjeni dokumentet e nevojshme për aplikim për akreditim të programeve të reja.

Programet të cilat do te aplikojnë për akreditim janë

Juridik, LLB niveli VI, 240ECTS, Kampusi Kryesor

Të gjitha këto dokumente në gjuhën shqipe dhe atë angleze, janë të vendosura edhe në formë elektronike (CD)

Me respekt
Alejtin Berisha



KOLEGJI UNIVERSUM

Adresa: Imzot Nik Prelaj p.n, Ulpianë, Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 555 315

Mob: + 377 45 303425, 44 144 062

URL: <http://www.universum-ks.org>

Mail: info@universum-ks.org

DATE/A:	06.02.2017
REFERENC-Ë:	2983/2
PËR:	Znj. Furtuna Mehmeti U.D. e Drejtoreshës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim
NGA:	Uran Rraci, Drejtor Akademik
TEMA:	Kërkesë për aplikimin e programeve të reja

Të nderuar,

Me këtë letër përcjellëse të bashkangjitur gjeni dokumentet e nevojshme për aplikim për akreditim të programeve të reja.

Programet të cilat do te aplikojnë për akreditim janë

Dizajn i Integruar, BA niveli VI, 180 ECTS, Kampusi Kryesor ✕

Të gjitha këto dokumente në gjuhën shqipe dhe atë angleze, janë të vendosura edhe në formë elektronike (CD)

Me respekt
Uran Rraci
Drejtor Akademik

